



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVO



Nr. 02/_____
Datë: 20.02.2026

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 23.02.2026
PRIMLJENO:
Mr.No.Br. 02/42

Procesverbal

i mbledhjes së -I- (parë për vitin 2026) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 04/534 të datës: 29.08.2025 për miratimin e Projekt Buxhetit për vitin 2026-2028
2. Të ndryshme

Mbledhja u mbajt me datë; 16.01.2026 duke filluar në orën 14:20

Morën pjesë 7 anëtarë të Komitetit, Drejtori për Buxhet dhe Financa si dhe Zyra për Informim.

Fatmir Ademaj: Përsëritet për të gjithë. Kemi rendin e dites me të vetmen pikë të rendit të dites. Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Me 7 vota unanimisht ishin për

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 04/534 të datës: 29.08.2025 për miratimin e Projekt Buxhetit për vitin 2026-2028

Fatmir Ademaj: Fjalën ja kaloj drejtorit për buxhet z. Blerim Thaçi.

Blerim Thaçi: Faleminderit kryesues! Përsëritet për të gjithë. Së pari më lejoni të ju uroj mandatin e ri si asambleista dhe mandatin e ri si anëtar të ri në KPF. Ky buxhet është prezantuar në legjislaturën e kaluar mirëpo për shkaqe që tashmë dihen nuk ka mujt me shku në kuvend. Para juve së pari po prezantoj në vijat buxhetore sipas asaj që ka leju Ministria dhe planifikimin që kemi bërë me 29.08.2025.

Si total i buxhetit të vitit 2026 është 22.088.710.00 euro dhe e ndajme në 5 kategori ku paga është 13,077,454.00€

Komunalit në bazë të nevojave të Komunës vitin e kaluar i kemi pas 600.000 euro ne kemi kerku me ulë për arsye se kemi mbet në disa suficite dhe kemi planifikim të jetë rreth 500.000 euro. Subvencionet nuk kanë ndryshuar, vitin e kaluar janë parapa për 600.000 euro. Tek kapitalët kemi 5,355,444.00€. Unë dua t'ju njoftoj edhe paraprakisht se vlera e këtij kapitali mund të rritet me arsyetimin e bartjeve të tjera të vitit të kaluar, që ne si total kemi tejkaluar 1.041.000 euro, që domethënë që është një shumë e grumbulluar nga Komuna dhe që na lejohet ti shpenzojmë në vitin 2026.

Diçka që kërkoj para jush para se mi marr mendimet dhe kërkesat e juaja është se para juve kemi paraqitur si kërkesë të ndryshimit të tij prej buxhetit në gusht në disa vende sidomos kapitalët, si ndryshim e kemi futur edhe një projekt si rinovimi i sallës së Kuvendit.

Projekti nuk është gati, por ne kemi planifiku që të ndajmë mjete që të jetë si kod i ri rinovimi i sallës. Pastaj, mbas rastit të vërshimeve, ju e dini që kemi pas dëme dy (2) urat që na është Imponu; ura në Carrallukë dhe në Malishevë të statcioni. Pra këtu kemi planifiku këtë vit të rregullohen këto ura. Këto dy planifikime janë nga kapitalet, ndërsa disa pjesë tjera e kemi të obligushme hartën Zonale dhe PZHK-në, e cila paguhet nga kategoria e mallrav dhe shërbimeve që domethënë nuk është nga pjesa kapitale, por nga digjitalizimi i qytetit. Digjitalizimi i qytetit është në platformë që kanë kërku mu nda mjete në këtë pjesë, duke përfshirë edhe një platformë komunale për të cilën qytetarët mujnë me shfrytëzu, këto janë çka i paraqita para jush, por ne do t'i marrim parasysh edhe kërkesat e tjera të juaja dhe ne rekomandimet e juaja do t'i kalojmë në Kuvend dhe ta kalojmë si obligim buxhetin që e kemi të panifikuar.

Fatmir Ademaj: Faleminderit drejtor. E hapi debatin e pikës së parë ashtu siç e tha drejtori ky buxhet në vitin 2025 ka shku në KPF, po nuk ka pasë korum për të vazhduar, as nuk ka shku në Asamblenë Komunale. Buxheti është i njëjtë, rrjedhimisht me ndryshimet të cilat i paraqiti drejtori. Unë e hapi debatin për piken e parë të rendit të ditës.

Halil Morina: Përshendetje për të gjithë! Të them të drejtën, nuk kam mujt me shqyrtu sa duhet, përshkak se dje na ka ardh ky material dhe e kam pa krejt vonë dhe nuk është që kom mujt me analizu si duhet, por ajo çfarë është ma e rëndësishmja se është e ndërtuar në strukturë ashtu siç duhet në bazë të kërkesave ligjore. Ajo që unë konsideroj që është e nevojshme që ne sot me ja dhanë dritën e gjelbër këtij dokumenti që me shku në Kuvend, pra dhe kjo jep kohë dhe mundësi me shqyrtu pak ma gjerësisht dhe në qoftë se kemi ndonjë vërejtje, ne mund t'i japim argumentet tona të rekomandimeve tona dhe të bëjmë ndryshime nëse ka nevojë për ndryshim. Ato çka i permendi drejtori, disa të nevojshme dhe një prej tyre është salla e Kuvendit Komunal që së pari karriget nuk janë në gjendje të mirë dhe paraqitjet drejtpërdrejt përmes YouTube-it, cilësia është shumë e dobët, sidomos në këtë kohë të degjitalizimit. Në kuadër të këtij rregullimi të sallës së Kuvendit, shpresoj që është e paraparë që të paktën inqizimet, zëri dhe pamja jonë të duken më të mira për publikun që të shohin se çfarë ne po debatojmë.

Veton Zogaj: Përshendetje për të gjithë! Së pari, ju e dini se kështu e kam mbështetur Komunën në aspektin e të hyrave vetanake, d.m.th. në mandatin e kaluar ka performuar jashtëzakonisht mirë. Ajo që më ka rënë në sy në këtë planifikim buxhetor që është bërë, e kam pa që në disa pika ka përsëritje të projekteve dhe besoj që është mirë me i sqaru. Po shpresoj që ka me qënë edhe kryetari në Kuvend. Shembull, tek investimet kapitale është rregullimi i energjisë eficiente, po e shoh te gjimnazi "Hamdi Berisha" është kjo, ka edhe tjera, "Tahir Sinani", salla e sportit "Habib Zogaj" e kështu me radhë, po te gjimnazi unë kam dëgju që është kry si projekt. Pse figuron prap në buxhet? Pastaj e kemi ndertimi, trajtimi dhe pastrimi i shtratit lumit Mirusha. Unë e di që është duke u zhvillu punimi aty, tash është kërku në këtë vit, nese nuk gabo, 500.000 mijë euro është shuma e paraparë, ndërsa kërkohet deri 2027, 482.000 mijë euro d.m.th. sa është ky projekt në total? Pastaj e kam një dilemë për parkun e sheshit në qendër të Malishevës. 20.000 mijë euro janë paraparë këtë vit dhe është i njëjti projekt që kërkohet rregullimi i qendrës së sheshit 1.2 milionë euro.

A po bëhet fjalë për të njëjtin projekt edhe pse po janë të ndara, dhe ne e dimë se si projekt është promovu dhe lëshu në shfrytëzim për qytetarët? Dua një sqarim nese mundesh. Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatrat e Komunës së Malishevës 100.000 mijë euro. Specifikoni në

cilat fshatra. Pastaj e kemi asfaltimin e rrugëve në disa pjesë, të cilat duhet emërtu ku aksat 0.1 dhe 0.2. D.m.th. secilin fshat e kemi me emertime të sakta, të paktën ndoshta është më mirë me i cek me emra. Ndërtimi i shtëpisë për persona me aftësi të kufizuara është projekt që Komuna është duke e bërë me "Jetimat e Ballkanit". Ne i kemi në këtë vit 50.000 euro në këtë projekt. Sa është shuma totale që kemi me participu ne si komunë? Ndërtimi i monumentit në sheshin në Malishevë. A bëhet fjalë për këtë në sheshin e Malishevës? A ka me u vends shtatorja apo bëhet fjalë për një monument tjetër? Ndërtimi i muzeut në Pagarushë, a bëhet fjalë për muzeun e Nexhmije Pagarushës apo naj projekt tjetër, sepse si projekt ka qenë edhe më herët. Rregullimi i oborrit të palestrës "Habib Zogaj" shumë me vend. Rinovimi i shkollave fillore "Hasim Vokshi" me sa kujtoj unë ajo u rinovu dhe pse ka nevojë edhe këtë vit me u rinovu prap. Shkolla në Turjak ka përfunduar dhe ende është në planifikim. Ndërsa për të tjerat mendoj që ka ndodh prishja dhe është mirë me u rregullu. E përkrahi mendimin e Halilit që tha për rregullimin e sallës së Kuvendit dhe shpresoj që edhe ti kryesues të i rri sh gati. Deshta ta pyes drejtorin a është planifiku buxhet për Komitet jo obligative të Kuvendit?

Imran Xhyliqi: Përsëritet për të gjithë! Është fakt që është hera e parë për mua në këtë komitet dhe ju realisht e ceket që ky projekt-buxhet është i vitit 2025, që e keni paraparë, por nuk ka ndodh votimi dhe është i përsëritur. A është gjithëpërfshirës i përsëritur apo ka ndryshime? Unë nuk kam mujt me analizu krejt, puna që si material na ka ardh shumë vonë. Nga fshati ku unë vi, është fshati Marali, e bashkë me të janë të përfshirë edhe shumë fshatra të tjerë, e me thanë të drejtën vetëm 300.000.00 euro të përfshira 20 fshatra është pak hajgare të ndara. I vetmi senë që deshta me cek ke rregullimi i ujërave të zeza në Lubizhdë dhe Bubël dhe deshta me ditë a është vazhdim apo e re, sepse këtu po thot që është në vazhdim?

Fatmir Ademaj: Faliminderit Imran, a është dikush tjetër që do ta marrë fjalën?

Para se drejtori të japë sqarime për pyetjet që ju bënë, desha të ndalem te rinovimi i sallës së asamblesë. Ju e dini që unë kam qenë drejtor i administratës dhe me kërkesë është në procedurë fillimi i rinovimit dhe jam i bindur që deri në shtator duhet të na gjejë me një sallë të re.

Blerim Thaçi: E para, fillimisht në kuader të këtij buxheti, një pjesë e madhe e buxhetit e vitit 2026 janë projekte të kontraktume, siç i përmendët disa projekte, e besoj që këtë vit përfundon me punë, sepse është e planifikume pjesa e buxhetit për këtë kanalizim.

Ndërtimi i objekteve me efikasitet. Veton, edhe kur kam qenë drejtor i arsimit, e kam nënshkruar një marrëveshje me organizatat për realizimin e punimeve për objektet me efikasitet dhe ajo marrëveshje parashihet që në 7-8 vjet të kryhet obligimi i mjeteve. Fillimisht e kemi pas 70.000 mijë euro në vit me i pagu, ndoshta për dhjetë vjet 700.000 mijë euro, por është rrit marrëveshja. Tash kemi kalu në fazën prej 150.000 mijë euro obligim vjetor, d.m.th. si një lloj investimi me kredi. Tek lumi Mirusha, shtrati me vlerë të saktë është mbi 1.400.000 mijë euro. 625.000 mijë euro janë për performancën, pjesa mbi 800.000 mijë euro është pjesë e Komunës, që kemi lidh marrëveshje me zgjatë prej urës në urë dhe tash obligimi jonë është pjesa që kemi planifiku.

Rregullimi i sheshit që e përmendët është projekti në përfundim dhe tani kryhet obligimi final i sheshit që është ndërtu në kontratën 8.3 milionë. Ajo është tjetër, ajo është si çështja e mirëmbajtjes e atij projekti.

Tek sistemi i ujësjellësit nuk është specifiku saktë, sepse sipas informacioneve që i kemi nga zyra e kryetarit, kryetari që ka pas takim me përfaqësuesit e Hidroregionit, ata thonë se e kanë bërë një

projekt fizibilitetit vetë për Malishevë dhe janë paraparë disa vende dhe ne nuk kemi mujt me përcaktu se ku jemi. Në koordinim me ta do të bëhet ajo pjesë.

Rrugët nëpër fshatra, më të drejtë the Veton, por së pari Ministra nuk na lejon. Për sa i perket aksave të rrugëve është firma projektuese e rrugëve që ka dalë në teren. Ju njoftojë se është mbi 49 km, d.m.th. rreth 50 mijë metra asfalt, rrugë të reja që kanë për t'u shtrur. Tek kanalizimet janë planifiku 800.000 mijë euro, janë të planifikuar për krejt kanalizimet e fshatrave. Shto edhe të hyrat shtesë që do t'i kemi 800.000 sipas projekteve që ka ba Urbanizimi, i mbulojnë të gjithë pikat e kanalizimit nëpër fshatra.

Ndërtimi i shtëpisë për personat me aftësi të kufizuar është një marrëveshje që e kemi 10 ose 15 % të obligimit nga Komuna për shkak të infrastrukturës në kanalizim dhe gjera tjera.

Monumenti në sheshin e Malishevës është paraparë të jetë shtatorja e re e Adem Jasharit, do të jetë një monument që do të jenë të gjithë dëshmorët e Komunës së Malishevës.

Muzeu në Pagarushë, fshati ka kërkuar të ndërtojë një kullë ose muze të tregut që është mbajt në luftë, me kërkesën e tyre e kemi fut në planifikim.

Shkolla në Turjakë përshkakë të oblimeve që kemi që është dashtë me perfundu në vitin që shkoj dhe na ka mbetë pa perfundu, atë pjesën e obligimit që e kemi na ka mbetë për 2026 dhe të jetë funksionale shkolla.

Fusha sportive në Malishevë, e kemi pasur një dëgjim publik në përfaqësim të cilin nuk kemi mujt me realizu për shkaqe tjera dhe këtë vit do të ndërtohet fusha sportive në shkollën e Malishevës.

Fatmir Ademaj: Faleminderit. Në cilësinë e kryesuesit të kuvendit kërkojë që deri në seancën e votimit të buxhetit të shterim të gjitha mundësitë e komunikimit ligjor e zyrtar që ta kemi të qartë se çfarë duhet të bëjmë punën për komisionet që janë duke u themeluar. Edhe Halili e Vetoni kanë qenë pjesë e shumë trupave të Kuvendit e komisioneve e ku munden me na çu edhe në përmbarues privat, por të njejtën kohë me u bo edhe padi private pikërisht për moskryerjen e pagesave. Kështu që të gjinden format qoftë e komunikimit ligjor.

Blerim Thaçi: Unë jam i gatshëm, bile tash ti e ke një barrë më të madhe se je kryesues edhe me Ministrinë e Administratës e me Ganiun me u koordinu, ose nëse don shkojmë bashkë në ministri por aty e kem telashe edhe me hy, por në Thesar mundemi me shku që me ju kërku se si me vepru. Ata vetëm le të ma japin qasjen dhe lejen prej kujt me i marrë, nuk është problem.

Halil Morina: Ne kemi marrë informacione nga shumë komuna, ku komunat kanë pasur arsyjet e veta për këtë, por ajo çka është më paradoksale është se ne kemi marr vendim në Kuvend për pagesën e një komisioni ose komiteti, e kemi dërgu në MAPL për lighmëri, vendimi kthehet si i ligjshëm, por pagesa është e pa ligjshme. Pra si ka mundesi që një vendim të jetë i ligjshëm pastaj pagesa bëhet e paligjshme? Kur është e paligjshme, Ministria e Financave ta kthen si të paligjshme dhe ti e shfuqizon vendimin. Pra s'ka mundesi që një vendim i yni të jetë në fuqi dhe të njejtën kohë pagesa e atij vendimi të jetë e paligjshme. Kjo duhet të sqarohet një herë e mirë. Tek e fundit, ne do t'i mbajmë të gjithë komisionet dhe komitetet edhe nëse nuk paguhen sepse ato duhet ti mbajmë.

Veton Zogaj: Pa dashtë me zgjat debatin pajtoj edhe unë. Është shumë e qartë kjo por ndonjëherë nuk bënë me ra pre e disa procedurave burokratike që është vendosur në 2008-2009 në qeveri që

nuk është ndrruar ai zyrtari ligjor dhe ka ecur legjislacioni, ka ndryshuar dhe ka mbetur me të vjetrin. Ne e dimë se edhe si Kuvend kemi bartur të hyra vetanake kryerjen e këtyre obligimeve. Një vendim, kur e merr vizen në MAPL, ai është i plotëfuqishëm. Para se me u themelu, kisha pasë dëshirë me u sqaru, sepse po dalim shumë keq me njerez tonë.

Deshta ta pyes në këtë pikë drejtorin, a keni parë ne këtë planifikim buxhetor hapësirë që na si asamblesitë edhe si grupe politike me mujt me i propozu edhe kërkesa të caktuar që pastaj, nëse aprovohen prej shumicës, në këtë rast prej pushtetit, me votu edhe na buxhetin? Nëse VV vjen me 10 kërkesa apo projekte të caktuara, a ka hapësirë buxhetore me u përfshi apo thjesht është punë e kryer, që bile ne mos me u lodh me i sjell si propozime?

Blerim Thaçi: Këto janë paret e shpërndara në këto projekte. Propozim-ndryshimet i bëni ju mirëpo kur del një asambleist propozon për një projekt, ai pak a shumë duhet me ditë edhe koston e atij projekti edhe me cilin projekt me zëvendësu me të. Pastaj neve si drejtori na mbetet me u barazu.

Fatmir Ademaj: Nese nuk ka dikush diçka, atëherë më lejoni ta hudh rekomandimin për seancën e radhës të Asamblesë Komunale, miratimin e buxhetit komunal 2026-2028 .Kush është për?

5 ishin për

0 kundër?

2 abstenim?

Me 5 vota për, asnjë kundër, dy abstenime kalon rekomandimi për miratimin e buxhetit 2026-2028.

2. Të ndryshme

Fatmir Ademaj: Kam një vendim të KQZ-së, për shkak se një antarë i PDK-së ka dhënë dorëheqje dhe është zëvendësu nga KQZ-ja, dhe rekomandoj që edhe kjo të jetë pikë e rendit të ditës, dhenia e betimit të asamblesteve nga rradhët e PDK-së.

Kush është për që kjo pikë të futet në rendin e ditës .

Me 7 vota futet në rendin e ditës. A ka dikush në të ndryshme ?

Veton Zogaj; Unë e kisha vetëm një çështje të ndryshme. Këtu është puna e pajisjes me laptop të antarve të rinj të Kuvendit. Unë e di që kur i kemi marrë ne në heren e kaluar, e kemi nënshkruar një lloj dokumenti që me kthi pajisjen dhe që nuk e merr në rast se nuk e fiton mandatin ose nuk kandidon. A keni ba përpjekje si administratë me dërgu një email zyrtar ish asambleisteve në këtë rast që me i kthi paisjet dhe me i furnizu në pjesen tjeter të asambleisteve.

Fatmir Ademaj: Për këtë qeshtje unë kam kerku nga Sekretaria e Kuvendit dhe ju kemi dhënë afat deri ditën e sotme, datën 16, që të gjithë asambleistët me i dorëzu llapotopët. Më pas ata që janë rizgjedh, besojë që duhet me i marrë llapotopët e njëjtë, ka mundësi që me pas shenime por vetem si dorzim faktik. Të hënë obligohet të thirren të gjithë edhe një herë për me i sjell laptopët. Unë që në javën e parë kam kërku nga administrata, angazhimi ka fillu dhe kam pa që disa i kanë sjellë.

Halil Morina: Për këtë çështje shumica e institucioneve ka probleme me kthimin e paisjeve sidomos këto pajisjet teknologjike. Në një kohë të gjatë ato shkojnë drejt amortizimit. Ky kthimi tash është edhe një problem tjetër, sepse me një procedurë shumë të thjeshtë mundesh me i kthy krejt ato gjëra që kanë qënë në atë lloptop. Për këtë arsye është më mirë, nëse jo ne çka i kemi por anëtarëve të rinj më ju ble të ri. Edhe me ligj mundet mos me ta kthy, sepse për 4 vite mundet me u zhvlerësu.

Blerim Thaçi: Ka pas raste që është diskutu, por edhe unë e shoh ashtu nga ana ligjore, sepse një paisje siç është kompjuteri ose lloptopi që është i shfrytëzuar mbi 3 vite nuk e di a lejohet me u kthy, unë për mendimin tem nuk kisha preferu me kërk me kthy. Tek e fundit nuk është ndonjë shpenzim i madh me i marr të rinjë.

Veton Zogaj: Sipas ligjit thotë se në çdo vit ka 25% do të amatizohen pra për 4 vite ai është jo funksional. Deri në kohën ku të paisen me lloptop të rinj, administrata mundet me u kujdes me i pajis me material fizik.

Fatmir Ademaj: A ka dikush me shtu? Nëse nuk ka, këto dy pika rekomandohen për kuvend. Ju falenderoj për kohën!

Mbledhja përfundoi në ora 15:15

Procesmbajtëse:
Marigona Hoti



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Ademaj

